


KUNDËRSHTIM I NGRITJES SË ÇMIMIT TË ENRGJIS ELEKTRIKE

NGA: SHOQATA E MULLISËVE TË KOSOVËS PRISHTINË

PËR : ZYRËN E RREGULATORIT TË ENRGJETIKËS

LËNDA: KUNDËRSHTIM I NGRITJES SË ENRGJIS ELEKTRIKE



Nr. 260112
Data. 22.03.12

KEK-u edhe sivjet aplikoi pranë Zyrës Rregulatorit të Energjetikës për tarifa të reja të energjis elektrike për vitin 2012 duke ofruar tri variante për të mbuluar kinse koston e re të prodhimit të energjis elektrike.

Kërkesën e KEK-ut , e kundërshton Shoqata e Mullisëve të Kosovës me argumentet si vijojnë:

- KEK-u është bërë një trup me kokë të shkatruar nga se koka për zhvillimin e KEK-ut , dikur ka qenë Institutu "Inkos" të cilin njëherë e shkatruan dhe në fund e shkëputën nga trupi i tyre. Tash KEK-u po punon si trupi pa kokë.
- KEK-u aspak nuk i ka analizuar resurset e veta të brendëshme si dhe dobësitë organizative të faktorit kadrovik ku janë caktuar njerzit jo professional nëpër vende përgjegjëse ku kërkohet profesionalizëm të cilët në vendë që ta zhvillojnë dhe risin produktivitetin ata e pengojnë dhe e kérkojnë shpëtimin në ngritjen e çmimit të energjis elektrike.
- Interesi i populatës është që të furnizohet me çmime më të lira të artikujve themelor për jetesë si janë: gruri, mielli, buka ,vaji, krypa , sheqeri e tj. Këta artikuj po shiten disi me çmime të lira krahas vendeve në regjion si p.sh. çmimi i bukës është më i liri në regjion edhe pse mullit dhe furat punojnë me ngarkesa më të rënda tatimore (TVSH-ja) është 16% për grur, miell dhe bukë ndërsa në vendet në regjion ato janë më të ulta duke filluar nga 0% në Kroaci , 5% në Maqedoni dhe 8% në Sërbia. Gjithashtu shtetet në regjion i kanë ndihmuar mullisit dhe furtarët duke u dhërë huajzim grur nga Rezervat Shtetore të cilin e kthejnë në sezonën e korjeve.

Pra Industria Ushqimore është e ngarkuar në përgjithësi dhe mullisit në veçanti ku në vendin tone ka gjithësejt 98 Fabrika të blojës drithrave (mulli) ndërsa prej tyre punojnë vëm 58 dhe janë mbyllur 40 mulli. Në

mbylljen e mullive një ndër faktorët ka qenë dhe është çmimi i lartë i energjis elektrike.

Nëse lejohet ngritja e çmimit të energjis elektrike konsiderojmë se edhe gjysma e atyre mullive që janë duke punuar do të mbyllen dhe do të vije deri te ajo që populli jonë të mvaret nga importi edhe për miell edhe për bukën e gojës.

- Kërkojmë që për mullit për blojën e drithrave të caktohen tarifa të veçanta të energjis elektrike që do të ishin më të ulta si që ka vepruar Maqedonia. Kjo do të mundëson që most ë ngritet çmimi i bukës si artikulli themelor jetësor.
- “Blllok Tarifën” e konsiderojmë çmenduri dhe mjet për ta dëmtuar konsumatorin i cili është duke u keqpërdorur duke u ngarkuar me çmim të pakuptimt. Kur dikush blen (konsumon) në sasi më të madhe ai duhet të ket ulje të çmimit e jo të kundërtën si është duke vepruar KEK-u dhe lejuar Zyra e Rregullatorit të Energjetikës.

Mos e lejoni ngritjen e çmimit të energjis elektrike dhe insistoni që KEK-u të i shfrytëzoje kushtet dhe resurset që i ka të pa shfrytëzuara.

Më 22.03.2012

Prishtinë



Drejtori Ekzekutiv

Muhamed Farizi Ek.dipl.

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Muhamed Farizi'.